



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1667 Dt 28.09.2021

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara në nenin 49, paragrafin 1, nënparagrafin 9 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ nr 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (aneksi – I - MASHT) 7/2018 e UA 01/2018 për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 27.9.2021, mori

VENDIM

1. Aprovohet draft-Rregullorja për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja paraprake nr. 1201 të datës 11. 9. 2018.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Menaxhmentit.
3. Fakulteteve
4. Zyrës për komunikim me publikun



Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit të UMIB



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1667 Dt 28.09.2021

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara në nenin 49, paragrafin 1, nënparagrafin 9 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, si dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017 dt. 30.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ nr 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (aneksi – I - MASHT) 7/2018 e UA 01/2018 për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e datës 27.9.2021, miraton këtë:

RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E ZGJEDHJES, RIZGJEDHJES DHE
AVANCIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN
"ISA BOLETINI" NË MITROVICË**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik në titujt: profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, asistent universiteti dhe lektor në të gjitha fakultetet me përjashtim të disa lëndëve që u përkasin arteve të bukura në Fakultetin e Edukimit.
2. Çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në Statutin e UIBM lidhur me procedurat dhe kriteret për avancim dhe emërim të personelit akademik.

**Neni 2
Personeli akademik**

Në pajtim me nenin 164, paragrafi 2, të Statutit të UIBM, personeli akademik i Universitetit përbëhet nga: profesorë të rregullt; profesorë të asocuar; profesorë asistentë, asistentë universiteti, dhe lektorë.

Neni 3

Kriteret për emërim në titujt akademikë

Procedura vlerësuese për emërim në titujt akademikë mbështetet në kriteret që dalin nga aktiviteti në vijim hulumtues, shkencor dhe profesional.

Neni 4

Ndalesat për shpalljen e konkursit

1. Personeli i brendshëm akademik që ka marrëdhënie të rregullt të punës në UIBM mund t'i nënshtrohet konkursit për rizgjedhje apo avancim.
2. Personeli akademik i brendshëm që ka një funksion tjetër jashtë UIBM-së, e të cilit iu është shkëputur kontrata e rregullt e punës dhe që kompensohet vetëm për orët e realizuara në UIBM nuk ka të drejtë të rizgjidhet dhe as avancohet gjatë periudhës të ushtrimit të funksionit jashtë UIBM.
3. Personeli akademik që mban funksione publike dhe që ka pezulluar marrëdhënien e punës në UIBM, gjatë kësaj periudhe të pezullimit nuk mund t'i nënshtrohen konkursit për rizgjedhje dhe avancim.
4. Konkursi për avancim nuk mund t'i shpallet as anëtarëve të stafit akademik të cilët kanë masa disiplinore të plotfuqishme që në mënyrë shprehimore ndalojnë avancimin akademik.
5. Konkursi nuk mund t'i shpallet personelin akademik të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.
6. Këshilli Drejtues nxjerr rregullore përkitazi me lejimin dhe ndalimin e angazhimeve të stafit akademik jashtë UIBM-së.

Neni 5

Kushtet për fitimin e titullit akademik profesor i rregullt (profesor doktor, prof. dr.)

1. Në pajtim me nenin 168 të Statutit të Universitetit, personeli akademik, i cili ka titullin akademik "profesor i asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "profesor i rregullt" (profesor doktor), të paktën katër (4) vite pas fitimit të titullit akademik "profesor i asociuar", dhe kandidati duhet t'i ketë këto kualifikime:

1.1 gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit të asociuar;

1.2 të ketë udhëhequr tema të masterit dhe të doktoratës (mentorimi i doktoratave vlen 3 vjet pasi të themelohen studimet e doktoratës në programin përkatës në Universitet);



- 1.3 një numër të rëndësishëm të monografive (së paku dy (2) monografi; doktorata e publikuar njihet si një (1) monografi);
- 1.4 tekste mësimore (së paku një (1) tekst mësimor);
- 1.5 publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku pesë (5) punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare;
- 1.6 pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me më së paku pesë (5) pjesëmarrje aktive (të dëshmuara në njërën formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues);
- 1.7 përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;
- 1.8 aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës;
- 1.9 aftësi për udhëheqje akademike;
- 1.10 krijime ose punime të njohura artistike, të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit, të lëndët e arteve figurative dhe muzikore.

Neni 6

Kushtet për fitimin e titullit akademik profesor i asociuar (prof. asoc. dr.)

1. Në pajtim me nenin 169 të Statutit të Universitetit, aplikimi për fitimin e titullit akademik “profesor i asociuar”, bëhet të paktën, katër (4) vite pas fitimit të titullit akademik “profesor asistent”, dhe kandidati duhet të ketë:
 - 1.1 gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit asistent;
 - 1.2 një numër të rëndësishëm të monografive (doktorata e publikuar njihet si monografi);
 - 1.3 publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku tri (3) punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, në pajtim me aktet ligjore në fuqi;
 - 1.4 të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.5 të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
 - 1.6 të ketë krijuar punime artistike, të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për lëndë nga artet figurative dhe muzikore.



Neni 7

Kushtet për fitimin e titullit akademik profesor asistent (prof. ass. dr.)

1. Në pajtim me nenin 170 të Statutit të Universitetit, për titullin e profesorit asistent kandidati duhet të ketë:
 - 1.1. gradën e doktorit të shkencës (në lëndët e Arteve figurative dhe muzikore grada ekuivalente me të “master i arteve”);
 - 1.2. një numër të rëndësishëm të monografive (disertacioni i doktoratës njihet si monografi);
 - 1.3. publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 1 punim kryesor të publikuar në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, në pajtim me aktet ligjore në fuqi;
 - 1.4. të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.5. të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e fushës përkatëse;
 - 1.6. të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve.

Neni 8

Kushtet për fitimin e titullit asistent

1. Në pajtim me nenin 171 të Statutit të Universitetit, për titullin e asistentit kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1 të ketë të përfunduar me sukses studimet universitare dhe master në drejtimin përkatës;
 - 1.2 të jetë jo më i vjetër se deri në datën kur i mbushë tridhjetë (30) vjet për emërimin e parë; për Fakultetin e Mjekësisë deri në datën kur i mbushë tridhjetë e pesë (35) vjet;
 - 1.3 të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes. Ky kusht fillon të zbatohet pas akreditimit të studimeve të doktoratës në UIBM;
 - 1.4 të ketë notën mesatare, në secilin nivel, jo më pak se tetë (8).
2. Kandidatët për asistent që kanë mbaruar studimet në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë në kushte të barabarta kanë përparësi në raport me kandidatët tjerë që kanë përfunduar studimet në universitete tjera në Kosovë dhe rajon por jo edhe me universitetet evropiane.
3. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master.
4. Përjashtimisht, asistenti që është rizgjedhur dhe është doktorant (PhD. cand.), në mungesë të profesorit për lëndën mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet



bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimitdhënësi nga departamenti.

Neni 9 **Kualifikimet për lektor të gjuhëve të huaja**

1. Në pajtim me nenin 172 të Statutit të Universitetit, për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
 - 1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se tetë (8), në secilën prej këtyre studimeve.
2. Lektorët në fakultetet e tjera pos në fakultetin amë i kanë të gjitha të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.

Neni 10 **Përkufizimet lidhur me nenet 5-9**


1. Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie, i publikuar si botim i veçantë, në Kosovë ose vende të tjera, me ISBN dhe i kataloguar. Për titullin prof. ass. dr dhe prof. asoc. dr. duhet së paku një (1) monografi. Për titullin prof. dr., duhen së paku dy (2) monografi.
2. Tekst mësimor konsiderohet libri universitar i publikuar në UIBM në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj si autor i parë për nevoja të studentëve në fushën përkatëse. Libri duhet të jetë i botuar në formë të shtypur apo elektronike, të jetë i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt dhe të ketë ISBN. Pranohet edhe teksti për përdorim të brendshëm me ligjërata/ushtrime, i botuar në formë të shtypur ose elektronike, i shqyrtuar nga së paku 2 recensentë, së paku me titull dr. sc. në fushën e njëjtë ose të afërt konform Rregullores për botime të UIBM. Kandidati për titullin prof. dr., duhet të ketë së paku 1 tekst mësimor.
3. Kandidati mund të jetë autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare. Autor korrespondent konsiderohet autori i punimit i cili shprehimisht është përcaktuar si i tillë në punim. Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë 1 (një) autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent. Punimi duhet të botohet në revistat shkencore ndërkombëtare të indeksuara në ndonjërin prej këtyre dy databazave:



3.1. Web of Science: <http://mjl.clarivate.com> (në ndonjërin prej koleksioneve bërthamë: SCIE; SSCI; AHCI)

3.2. Scopus (Elsevier): <https://www.scopus.com>

4. Punimet e publikuara sipas kërkesave të kësaj rregulloreje nuk merren parasysh nëse në fazat e vlerësimit deri në momentin e marrjes së vendimit përfundimtar konstatohet që revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave ose botuesve të dyshimtë. Revista të dyshimta konsiderohen revistat, të cilat nuk e aplikojnë procesin e vërtetë të recensionit profesional (peer review), nuk kanë ISSN të vërtetë, nuk kanë uebfaqe ose kanë një të tillë të dyshimtë, personi juridik apo fizik botues nuk ka adresë ose numër kontakti, deklaron adresë ose numër kontakti fiktiv, paraqet indeksim ndërkombëtar të rremë, deklaron faktor ndikimi të rremë, botuesi i tyre është i dyshimtë në kuptimin e mënyrës së menaxhimit dhe paletës së revistave që publikon (shih si shembull referues: <https://beallist.net/>). Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë njohjen e publikimit në revistat e dyshimta ose botuesit e dyshimtë, por para vlerësimit përfundimtar të kandidatit.
5. Për shkencat e albanologjisë, kandidati mund të jetë autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore vendore apo të Shqipërisë dhe vendeve tjera të rajonit me redaksi ndërkombëtare.
6. Kandidati në rastin e zgjedhjes në thirrjen prof. ass. dr, duhet të jetë autor i parë i së paku një (1) punimi. Në rastin e zgjedhjes në titullin prof. asoc. dr, kandidati duhet të jetë autor i parë i së paku dy (2) prej punimeve dhe autor korrespondent në së paku një punim. Në rastin e zgjedhjes prof. dr., kandidati duhet të jetë autor i parë i së paku tri (3) prej punimeve dhe autor korespondent në së paku dy (2) punime.
7. Kandidati për t'u avancuar në thirrjen prof. dr., duhet të ketë pesë (5) punime të publikuara në revistat e përcaktuara nga kjo rregullore pas marrjes së titullit prof. asoc. dr. Kurse, për t'u avancuar në thirrjen prof. asoc. dr, duhet të ketë (3) punime të publikuara pas marrjes së titullit prof. ass. dr.
8. Kandidati për titullin profesor i rregullt duhet të dëshmojë pjesëmarrje aktive në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me më së paku pesë (5) pjesëmarrje aktive të dëshmuara në njërin formë: me proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendën e konferencës si referues. Në rastin e zgjedhjes prof. dr., kandidati duhet të jetë autor i parë i së paku tri (3) punimeve prej proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendave të konferencave si referues, dhe kurse si autor i dytë/korrespondues mund të jetë në dy prej punimeve në proceedings book, botim të abstrakteve apo agjendave të konferencave si referues. Rekomandohet pjesëmarrja aktive në së paku në dy konferenca të organizuara nga UIBM, për avancimin e stafit akademik.



9. Kandidati për titullin profesor i rregullt duhet të dëshmojë se ka mentoruar me sukses së paku 1 temë master dhe ka mentoruar ose është në proces të mentorimit të së paku 1 kandidati në studimet e doktoratës. Mentorimi i doktoratave vlen 3 vjet pasi të themelohen studimet e doktoratës në Universitet. Në mungesë të dëshmisë së mentorimit të studentëve të doktoratës, kandidati duhet të dëshmojë që është së paku në proces të bashkëmentorimit të një kandidati (nuk pranohet më shumë se 1 bashkëmentor për 1 doktorant) ose të ketë marrë pjesë në së paku një komision për mbrojtje/vlerësim të punimit të doktoratës dhe të ketë botuar në cilësinë e autorit të parë ose korrespondent në së paku 1 punim më shumë se minimumi i nevojshëm për titullin profesor i rregullt.
10. Gjatë vlerësimit të kandidatit mund të pranohen edhe punimet, për të cilat ka konfirmim nga revistat përkatëse se janë të pranuar (accepted) për t'u publikuar, me kusht që të mos ketë kandidatë të tjerë që i plotësojnë kushtet tjera dhe tashmë kanë numrin përkatës të punimeve të publikuara.
11. Aftësia për mësimdhënie dhe ajo pedagogjike dëshmohen nëpërmjet dy (2) certifikatave për metodologji të mësimdhënies të fituara nga qendra përkatëse e themeluar në UIBM apo nga institucione të tjera të specializuara vendore dhe ndërkombëtare. Për kandidatët e jashtëm pranohet edhe referenca për aftësinë pedagogjike dhe të mësimdhënies nga njësi përkatëse akademike, në të cilën kandidati ka realizuar përvojën e nevojshme të punës.
12. Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme nënkupton pjesëmarrjen së paku në një projekt, program apo grup tjetër punues (si anëtarë në hartimin apo zbatimin e dokumenteve strategjike, shkencore dhe të aplikueshme, akteve normative të lidhura me fushën e eksperiencës, redaktime shkencore në libra akademikë, ekspertiza apo trajnime profesionale e të ngjashme) përmes të cilave arrihen rezultate me rëndësi për universitetin, industrinë dhe komunitetin.
13. Aftësia për udhëheqje akademike nënkupton aftësitë dhe kontributin e shprehur përmes angazhimit si anëtar i komisioneve vlersuese për zgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik, komisioneve për mbrojtje të temave master dhe doktoratë, pjesëmarrjes si recensent i monografive dhe teksteve mësimore, pjesëmarrjes në këshillin shkencor të konferencave vendore apo ndërkombëtare.
14. Jo më i vjetër se 30 vjet konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati i mbush 30 vjet dhe llogaritet deri në ditën e përmbylljes së konkursit.
15. Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë rregullore.



Neni 11
Intervistimi i kandidatëve

1. Për krijimin e marrëdhënies së punës për herë të parë në titullin asistent dhe titullin profesor asistent në Universitet mbahet intervistë me gojë.
2. Në intervistë vlerësohet përshtatshmëria e kandidatit lidhur me aftësinë pedagogjike dhe atë të mësimdhënies.
3. Komisioni vlerësues, në kushte të barabarta, do t'i japë përparësi kandidatit i cili vlerësohet më shumë lidhur me aftësitë pedagogjike dhe atë të mësimdhënies. Kur dy candidate janë të njëjtë i jepet përparësi kandidatit me gjini femërore.
4. Komisioni vlerësues duhet shprehimisht që në raportin vlerësues të sqarojë arsyet e dhënies së përparësisë të një kandidati duke u bazuar në intervistën me gojë.
5. Komisioni vlerësues ka përgjegjësi ligjore për vlerësimin e kandidatëve në intervistë.

Neni 12
Fusha e ngushtë e kandidatit

1. Komisioni vlerësues ka obligim ligjor që në çdo vlerësim të kandidatëve për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të konstatojë nëse fusha e kandidatëve përkon ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi.
2. Komisioni vlerësues duhet që në raportin vlerësues të përfshij shpjegimet e nevojshme lidhur me përshtatshmërinë (fushën e ngushtë të studimeve) e kandidatit me lëndët që janë pjesë e konkursit.
3. Komisioni vlerësues vlerëson dhe konstaton fushën e ngushtë të kandidatëve në nivelin baçelor dhe master për titullin e asistentit kurse për titullin e profesorit së paku nivelin master dhe të doktoratës.
4. Komisioni vlerësues duhet t'i japë përparësi kandidatit me fushën më të ngushtë të studimeve.
5. Komisioni vlerësues duhet t'i refuzojë kandidatët që nuk e kanë fushën e ngushtë të studimeve në raport me lëndët për të cilat është shpallur konkursi.
6. Komisioni vlerësues duhet që edhe në rastin e punimeve shkencore të konstatojë se janë në fushën e kandidatit në raport me lëndët e konkursit.
7. Komisioni vlerësues mban përgjegjësi ligjore lidhur me konstatimin e përshtatshmërisë (fushën e ngushtë të studimeve) së kandidatit me lëndët që janë pjesë e konkursit.



Neni 13
Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet bëhen për kohëzgjatje 4 vjeçare, me përjashtim të titullit prof. dr., të cilit i lëshohet kontratë me kohë të pacaktuar sipas legjislacionit të fuqi.
2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit.
3. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitat.
4. Titulli i parë që fitohet në UIBM për kategorinë e mësimit është profesor asistent, ndërsa gjatë procesit të avancimit nuk lejohet tejkalmi i thirrjeve të parapara me Statutin e UIBM.
5. Thirrja e fituar në UMIB mund të revokohet vetëm në këto raste:
 - 5.1. Falsifikimi apo mashtrimi gjatë vlerësimit ose provimit;
 - 5.2. Plagjiatura apo shkelja e të drejtës së autorit në përgatitjen e diplomës apo të punimit tjetër me shkrim;
 - 5.3. Praktikë tjetër joligjore dhe joetike.
6. Kriteri i moshës së përcaktuar në nenin 171 të Statutit të UIBM vlen për kandidatët të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës për herë të parë në lëndët e konkursit të shpallur. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin “Isa Boletini”, në Mitrovicë, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm apo i rregullt por në fushë tjetër (lëndë tjera) para moshës së përcaktuar sipas nenit 171 të Statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së parapara me Statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
7. Bazuar në Ligjin e Punës, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
8. Në UIBM nuk lejohet zgjedhja, rizgjedhja apo avancimi i kandidatëve brenda ndonjëre prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program) nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind- fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas). Në rastet tjera të ekzistencës potenciale të konfliktit të interesit zbatohen rregullat nga legjislacioni përkatës në fuqi.
9. Në secilën instancë të rekrutimit të kandidatëve duhet të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Deklarata për parandalimin e konfliktit të interesit që duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit recensues është pjesë përbërëse formularit (raportit vlerësues).



10. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare

Neni 14 **Personeli i angazhuar**

Kriteret dhe procedurat për angazhimin e personelit të angazhuar, rregullohen me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Senati i UIBM.

Neni 15 **Procedurat e konkursit**

1. Procedura përzgjedhëse për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse.
2. Konkursi shpallet me vendim të Senatit, pas aprovimit të propozimeve të fakulteteve.
3. Fakultetet nuk mund të kërkojnë shpalljen në konkurs të pozitave të cilat lidhen me personelin e rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.
4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune sipas paragrafit 3 të këtij neni, nuk ka të drejtë të aplikojë në konkurs, meqë të njëjtit, me vendim të Rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
5. Personelit të zgjedhur për pozitat sipas paragrafit 3 të këtij neni, i lëshohet kontrata e punës valide pas pensionimit të personelit përkatës të rregullt në ato pozita.
6. Fakultetet, propozimet e tyre duhet t'i bazojnë në nevojat reale, numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve që duhet të ketë një vend pune, për tu zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, asistentit dhe lektorit.
7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse Fakulteti ofron dëshmi, që për atë pozitë ekziston fond i orëve.
8. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të caktuara të punës për personelin akademik, edhe nëse ai vend pune nuk është paraparë me propozimin e Fakultetit.
9. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Statutit të Universitetit dhe të kësaj Rregulloreje.
10. Konkursi shpallet në ueb-faqen e Universitetit. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.



11. Punëdhënësi në sektorin publik është i detyruar që një kopje të shpalljes së konkursit publik ta dërgojë në Agjencionin e Punësimit të Republikës së Kosovës (MPMS).
12. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur (lidhje të fortë) dhe në formë elektronike.
13. Dokumentacioni i shtypur (lidhja e fortë) duhet të dorëzohet në Fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të Universitetit, që është përshkruar në konkurs.

Neni 16 **Komisionet vlerësuese**

1. Fakulteti është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë komisionin vlerësues.
2. Brenda (10) ditëve pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit në të cilën merret vendimi për themelimin e komisioneve vlerësuese dhe komisionit të ankesave në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Anëtar të komisionit të ankesave nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit dhe departamenteve përkatëse si dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese.
4. Komisioni vlerësues propozohet nga radhët e stafit akademik në nivel të departamentit/ degës ose programit dhe aprovohet në këshillin e fakultetit.
5. Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
6. Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët për të cilat është shpallur konkursi.
7. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë tituj më të lartë akademikë ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën ka aplikuar kandidati.
8. Këshilli i Fakultetit zgjedh se cili prej anëtarëve të Komisionit vlerësues do të jetë edhe kryetar i komisionit. Anëtari i komisionit vlerësues me titull më të lartë akademik, me automatizëm, është kryetar i komisionit. Në rastet kur më shumë se një anëtar i komisionit ka titull më të lartë përkatësisht në rastet kur të gjithë anëtarët e komisionit kanë titull të njëjtë me pozitën për të cilën ka aplikuar kandidati, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër në moshë përkatësisht anëtari i caktuar me konsensus.



9. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.
10. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm – nga Universiteti. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me automatizëm është kryetar i komisionit.
11. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 6, 7 dhe 9, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë titujt e nevojshëm akademikë nga lëmenjtëi përkatës dhe të cilët nuk e kanë kaluar moshën 70-vjeçare. Në rastet kur brenda Fakultetit/ Universitetit nuk ka profesorë që mund të jenë anëtarë të komisionit, atëherë të tre anëtarët mund të jenë të jashtëm nga universitete të tjera.
12. Në rast të arsyeve të bazuara, anëtari i komisionit në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të komisionit vlerësues mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni. Në këtë rast, Dekani i Fakultetit brenda shtatë (7) ditëve thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit dhe në rast të aprovimit të dorëheqjes, kërkon nga këshilli plotësimin përkatësisht formimin e komisionit tjetër vlerësues.
13. Administrata e fakultetit duhet t'ia ofrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm komisionit vlerësues.
14. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe të hartojnë raportin e vlerësimit, si dhe procesverbalin lidhur me vendimmarrje.
15. Komisioni vlerësues është i obliguar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas mbylljes së konkursit të dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar.
16. Këshilli i Fakultetit përkatës ka të drejtë të ndryshojë përbërjen e komisionit vlerësues përkatësisht të formoj komision të ri nëse konstatohet se komisioni nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë rregullore në lidhje me raportin vlerësues.
17. Pas ndryshimit të përbërjes së komisionit vlerësues, Këshilli i Fakultetit i jep afat komisionit edhe dhjetë (10) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.
18. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit, këtë Rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
19. Komisioni vlerësues duhet t'i ftojë në intervistë kandidatët të cilët zgjedhen për herë të parë në UIBM.



20. Komisioni vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor/artistik, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim me kandidatët e tjerë. Komisioni duhet të arsyetoj rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.
21. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur.
22. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet minimale por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të cekën kushtet të cilat nuk i kanë plotësuar.
23. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga të tre (3) anëtarët, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në Këshillin e Fakultetit përkatës.
24. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit vlerësues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një "propozim të ndarë" për Këshillin e Fakultetit përkatës. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Statut dhe të detajuara në këtë Rregullore. Në raste të tilla, Këshilli i Fakultetit i diskuton të dy propozimet dhe e dorëzon në Rektorat propozimin që është miratuar nga Këshilli, duke përfshirë informacionin për mendimet e ndara. Këshilli i Fakultetit mban të drejtën të refuzojë të dy propozimet, por nuk mund të miratojë të dy propozimet për të njëjtën pozitë.
25. Në raportin e Këshillit të Fakultetit duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs.
26. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi, nëse të njëjtat bien qartazi ndesh me Statutin e UIBM – it dhe këtë Rregullore.

Neni 17

Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni vlerësues

1. Këshilli i Fakultetit, pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës, jo më vonë se shtatë (7) ditë, të konstatojë se të dhënat e kandidatëve janë përfshirë në mënyrën e duhur në formularin përkatës (raportin e komisionit vlerësues). Në rastet kur formulari i lartcekur nuk është plotësuar konform rregullores, Këshilli i Fakulteti e kthen edhe një herë rastin te komisioni vlerësues, i cili ka afat prej 3 ditësh për plotësimin e formularit të ri.



2. Këshilli i Fakultetit përkatës, pas mbajtjes së mbledhjes dhe konstatimit të gjendjes së raporteve vlerësuese, brenda tre (3) ditëve i përcjell raportet vlerësuese në verzionin elektronik pranë zyrës për çështje akademike të Universitetit.
3. Zyra për çështje akademike e Universitetit është e obliguar që brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e Këshillave të Fakulteteve, të hartojë buletinet dhe të njëjtit t'i publikojë në web-faqen e Universitetit.
4. Buletinet duhet të qëndrojnë të publikuara në web-faqe të Universitetit në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e publikimit.
5. Zyra për çështje akademike, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga Këshilli i Fakultetit përkatës nuk është në rregull me dokumentacion, atëherë duhet të kërkojë nga Prorektori për mësim që ta obligojë Fakultetin përkatës që të kompletojë dokumentacionin para se të dalë në Buletin.
6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në Buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë në Këshillin e Fakultetit përkatës.
7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në administratën e Fakultetit përkatës.
8. Këshilli i Fakultetit është i obliguar që pas kalimit të afatit të Buletineve, në afat prej dhjetë (10) ditëve, të vlerësojë raportet e komisioneve vlerësuese dhe të vendosë për miratim ose jo të atyre raporteve.
9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, Këshilli i Fakultetit është i obliguar që të shqyrtojë edhe raportin e komisionit të ankesave lidhur me ankesat e kandidatëve të parashtruara në fazën e publikimit të Buletineve dhe ndaj ankesave të japë përgjigje me shkrim.
10. Këshilli i Fakultetit është e obliguar që, pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth shqyrtimit të ankesave ti dorëzojë brenda tre (3) ditëve pranë zyrës për çështje akademike të Universitetit.
11. Zyra për çështje akademike, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga Fakultetet përkatëse, është e obliguar që të informojë Prorektorin për mësim dhe Prorektori për mësim të kërkojë nga dekanati i Fakultetit përkatës që të kompletojë lëndët.

Neni 18

Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit të Fakultetit në Senat

1. Komisioni i studimeve shërben si organ këshillëdhënës për Senatin.
2. Propozimet e këshillave të njërive akademike për zgjedhjen e anëtarëve të personelit akademik shqyrtohen fillimisht nga Komisioni i studimeve, i cili i rekomandon Senatit pranimin ose refuzimin e propozimit në afat prej 30 ditëve pas pranimit të propozimeve.



3. Nëse propozimi refuzohet nga Senati, ai i rikthehet për rishqyrtim Këshillit të njësisë akademike brenda tri (3) ditëve.
4. Këshilli i fakultetit obligohet që brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit të senatit të rishqyrtojë lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzojë, brenda tri (3) ditëve, pranë zyrës për çështje akademike të universitetit.
5. Nëse Këshilli i njësisë akademike, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar.
6. Vendimi i Senatit për miratim apo refuzim të propozimit të Këshillit të Fakulteteit merret brenda 60 ditësh. Në rastin e rikthimit të propozimit për rishqyrtim nga ana e Këshillit të Fakultetit vendimi në Senat merret brenda 30 ditësh.
7. Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë të drejtën e njohjes së publikimit në revistat, të cilat janë të dyshimta.

Neni 19

Vendimi për zgjedhje, periudha e ankimit dhe kohëzgjatja e procedurës së konkursit

1. Procedura e votimit në Senat për zgjedhjen e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
2. Ndaj vendimit të Senatit, në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimi në dorëzim të njoftimit për vendim, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrësia, si instancë e e fundit e ankimit në UIBM. Ankesa shqyrtohet brenda 15 ditësh nga dita e pranimi.
3. Në rastet kur anëtari i personelit akademik i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, mbetet në thirrjen e njëjtë.
4. Konkursi për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UIBM-së për të gjitha vendet e shpallura jo më gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të rektorit, afati i gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimum në 30 ditë.
6. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të përcaktuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës të fakultetit.



Neni 20

Dispozitat kalimtare

1. Kjo rregullore nuk zbatohet për konkurset që janë filluar me rregulloren paraprake nr. 1201 të datës 11. 9. 2018.
2. Për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim deri më datë 31.12.2023, do të vlejnjë të gjitha punimet shkencore të publikuara si autor i parë në të gjitha databazat e precizuara nga shtojca 1 (formular për aktivitetin hulumtues, shkencor dhe profesional) e Rregullores paraprake nr. 1201 të datës 11.9.2018. Punimet shkencore sipas këtij paragrafi duhet të jenë të publikuara në revista shkencore para hyrjes në fuqi të rregullores sipas neni 21.
3. Për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim, nga data 01.01.2024, do të merren parasysh vetëm punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare dhe të indeksuara në platformat vijuese: Web of Science (SCIE, SSCI apo AHCI) dhe Scopus (Elsevier).
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të pranohen për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim vetëm punimet shkencore që do të publikohen në databazat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni. Përrjashtimisht, punimet e personelit akademik që paraprakisht janë dorëzuar për shqyrtim në revista ndërkombëtare para miratimit të kësaj rregulloreje do të pranohen për avancim të stafit akademik vetëm nëse publikohen para datës 15 Qershor 2022. Instancat përkatëse në fakultet dhe rektorat rezervojnë të drejtën për verifikim dhe ofrimin e dëshmimeve nëse punimet e tilla janë dorëzuar për vlerësim para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
5. Në pamundësi për të plotësuar kushtet e reja ligjore të dala në Statutin e ri të UIBM-së, personelit akademik që u skadon kontrata me titullin prof. asoc. dr., u mundësohet vazhdimi automatik i kontratës për një periudhë kohore më së shumti 2 vjeçare. Vendimin për këtë e merr Senati sipas propozimit të Këshillit të Fakultetit. Vazhdimi i kontratës në periudhë kohore 1 vjeçare iu mundësohet edhe stafit akademik që është në procedurë të avancimit (në thirrjen prof. asoc. dr dhe prof. dr.), pas datës 1. 1. 2023, dhe që nuk mund t'i plotësojë kushtet ligjore për publikimin e punimeve shkencore në databazat e cekura më lartë në paragrafin 3.
6. Zyra e rektorit brenda afatit prej 15 ditëve nga miratimi i kësaj rregulloreje përpilon formën e raportit vlerësues u cili shërben për punën e komisioneve vlerësuese. Raporti përmban të gjitha pjesët/elementet që kërkohen të evidentohen lidhur me zgjedhjen, rizgjedhjen dhe avancimin e stafit akademik.
7. Senati brenda 3 muajve pas miratimit të kësaj rregulloreje, duke u bazuar në nenin 173 të Statutit nxjerr rregullore të veçantë për ekuivalentimin e personelit akademik të lëndëve të artit figurativ dhe muzikor.



Neni 21
Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja paraprake nr. 1201 të datës 11.9.2018.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

 Prof. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit të UIBM